

VENDIM
Nr. 270, datë 9.7.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 39, DATË 1.6.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME KONISPOL”, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 100, DATË
25.8.2020**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-janr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 9.7.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 1.6.2018, ‘Për Licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol’, të ndryshuar me vendimin nr. 100, datë 28.8.2020””.

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol (UK Konispol), me shkresën nr. 62 prot., datë 7.6.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol” ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Konispol për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Konispol me vendimin nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Konispol sh.a., z. Mikelo Taka, ka

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Konispol”, të ndryshuar me vendimin nr. 100, datë 25.8.2020, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues teknik: Mikelo Taka.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Fatime Imeraj